Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 457/18 461/18
Datë/Datum 02.10.18
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 457.461/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: OE: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë dhe OE "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti", me nr. prokurimi: 60100-18-404-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kadastrale e Kosovës, më datë: 19.09.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET,** pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë dhe "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti", me nr. prokurimi: 60100-18-404-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kadastrale e Kosovës.

II. **ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës me titull: "Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti", me nr. prokurimi: 60100-18-404-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kadastrale e Kosovës, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë dhe OE "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, aprovohen pjesërisht si te bazuara, iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohen operatoret ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 05.02.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt:23.02.2018, ku kanë marrë pjesë tre (3) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë dhe "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, si tenderues të pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt: 15.08.2018.

Njoftimi i anulimit të aktivitetit nga Autoriteti Kontraktues është bërë me dt: 20.08.2018.

Kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit operatoret ekonomik: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë dhe "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, me dt: 17.08.2018, dhe 20.08.2018, kanë bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 23.08.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesat për rishqyrtim të operatoreve ekonomik: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë dhe "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 03 Shtator 2018, me nr. 457/18, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti", me nr. prokurimi: 60100-18-404-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kadastrale e Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 64, 65, 66, 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Operatori ekonomik ankues: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 27 Gusht 2018, me nr. 461/18, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat: Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti", me nr. prokurimi: 60100-18-404-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Kadastrale e Kosovës, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 13.4, 59, 65 - 68, 69, 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.09.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore. Eksperti shqyrtues në raportin e dt: 11.09.2018, sqaron:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:"Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë; Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se AK ka shkelur nenet 64, 65, 66, dhe 69 te LPP-se. Duke pas parasysh se OE ankuese konfirm nenit 108/A të LPP-së, ka pasur mundësi dhe është dashur qe paraprakisht te gjitha pretendimet e veta ti parashtron pran AK, e qe ne rastin konkret OE ankuese këtë pretendim nuk e ka parashtruar fare pranë AK me kërkesën për rishqyrtim, eksperti shqyrtues bazuar ne nenin 109 te LPP-se si dhe paragrafit 9.2 te nenit 9 te dokumentit F03 Rregullat për parashtrim te ankesave-verzioni 2, ku thuhet: *"Ankesa do te dorëzohet ne origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues"* si dhe neni 13 par. 9 i Rregullores se OSHP-se Nr. 01/2017 ne te cilën thuhet: "*Ankesa duhet te jene te qarta, e shkurtër , dhe me pretendime e supozuara*

qe eventualisht janë shkelur nenet e caktuara te LPP-se nga ana e Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore parimisht duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues", andaj nga te cekurat si me larte pretendimi ne fjale nuk është trajtuar nga eksperti shqyrtues. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron,sqaron se OE ankues nuk ka arritur te dëshmoj interes material nga rezultati i aktiviteti te prokurimit te zbatuar nga AK – AKK ne pajtim me nenin 4 par. 1.26 te LPP-se, po citoj: "*Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*",prandaj, bazuar ne Vendimin OSHP-se Nr. 111/18 dhe Urdhëresën e OSHP-se Nr. 218/18,OE ankues nuk plotëson kërkesat ne njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe është pale pa interes ne këtë aktivitet të prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues: N.Sh."GeoMap" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera"shpk & "Newa" shpk – Prishtinë.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues nuk respektuar nenin 7, 59, 65, 69, dhe 72të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se bazuar në Rregulloren Nr. 01/2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, neni 16 (Rastet e unifikuara) par. 2) dhe 3), janë përsëritur, pretendimet ankimore te njëjta për palët ne procedurë lidhur me këto pretendime ankimor, ku objekt i kontestit dhe palët janë te njëjta, për rastet te cilat janë shqyrtuar me parë, si çështje te gjykuara "resjudikata", sipas nenit 105.2.16 te LPP-së. Gjithashtu, eksperti shqyrtues sqaron si ne vijim: Është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritetit kontraktues respektivisht e komisionit të vlerësimit/Ri-vlerësimit që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave në mënyrë që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve me kusht që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin të bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, duke marr parasysh Aneksin 1 në dosje të tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron, se komisioni i Ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit dhe nuk ka respektuar vendimin e OSHP-së me Nr. 111/18, te datës 10.05.2018 dhe Urdhëresën e OSHP-së Nr. 218/18, të datës 03.08.2018, dhe duke mos vepruar ne pajtim, në tërësi me dispozitat ligjore të LPP-së.

Eksperti shqyrtues profesional, duke u mbështetur në ekzaminimin e fakteve të prezentuara në dosjen e tenderit, raport, si dhe rrjedhën nga ana e AK-së, rekomandojmë që ankesa e OE: "Lorenco&Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë,për tenderin e AK – Agjencioni i Veterinarisë dhe Ushqimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:"Rindërtimi i informacioneve kadastrale ne 15 zona kadastrale komunat:

Drenas, Skenderaj, Kamenicë dhe Viti"me nr. prokurimi: 60100-18-404-2-1-1, Refuzohet si tëpabazuara (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet më lartë),ndera ankesa e OE: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk – Prishtine, aprovohet si te bazuara(për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet më lartë)dhe të njëjtin tender rekomandojmëAutoritetin Kontraktuesqë ky aktivitet i prokurimit të Ri-vlerësohetduke respektuar Urdhëresën e OSHP-se Nr. 218/18 e datës 03.08.2018 si dhe dispozitat ligjore në fuqi të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues – Agjencia Kadastrale e Kosovës, me datë: 14.09.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë, me datë: 14.09.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues: "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, me datë: 13.09.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 19.09.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesit e OE ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi OE ankues Lorenco & Co z.Jusuf deklaroj: Ja ofroj panelit shqyrtues si provë sqarimet tona lidhur me çështjet e eliminimit për diploma që sipas AK nuk janë adekuate. Ne jemi eliminuar me arsyen se topografi nuk është gjeodet. Nëse eksperti e ka marr këtë vendimin që topografi është gjeodet në çfarë provash është bazuar, në dëshirojmë ti shohim ato fakte, sepse nga ana tjetër në kemi shume fakte qe topografi dhe gjeodeti kryejnë te njëjtat punë.

Faktet tona: 1. web-sitet (Wikipedia) 2. Fletorja zyrtare e Republikës se Shqipërisë (Ligji i Shqipërisë)

3. Agjencioni Kadastral i Kosovës

4. Shoqata e gjeodeteve te Shqipërisë

5. Fakulteti i Gjeodezisë ne Shqipëri

6. Oda turke e gjeodeteve

7. Licenca e gjeodeteve

2. Ne fletoren zyrtare te Republikës se Shqipërisë janë te cekura te gjitha profilet te cilat mund te jene PROJEKTUES GJEODET.

3. Institucioni me i larte për gjeodezi pra Agjensioni Kadastral i Kosovës ka pranuar qe ata të gjithë janë gjeodet.

4. Shoqata e gjeodeteve nuk mund të jep përgjegjësi për anëtarë të tjerave drejtimeve jashtë anëtareve të saj. Kjo shoqatë është përgjigjur në një pyetje që ka të bëjë me gjeodetet dhe si e tillë nuk mund te merret si e pa bazë.

5. Fakulteti i gjeodezise në Shqipëri gjithashtu e ka shpjeguar çështjen e topografit, ku ndajnë të njëjtin mendim me shoqatën e gjeodeteve te Shqipërisë dhe gjithashtu me website (wikipedia).

6. Oda turke e gjeodeteve e ka jep mendimin i cili gjithashtu përputhet me përgjigjet tjera qe i kemi marr deri me tani.

7. Licenca e gjeodeteve -Asnjë lëmi tjetër nuk mund te licencohet me licence gjeodeti përveç atyre në këtë drejtim.

Eksperti shqyrtues mbron referencën e Fisnik Loshit.

Eksperti duhet te dëshmoj me fakte dhe pastaj te dal në mbrojtje të referencës, ne kemi fakte tjera që i kundërpërgjigjen kësaj referenca te cilat do ti deshmojme me radhe.

Referenca	Realiteti
Projekt menaxher - Fisnik Loshi	Projekt menagjer - Omur Engin Demirkol
Drejtor gjeneral – Erhan Jusuf	Drejtor gjeneral – Abdullah Yusuf Ekinci
Referenca e pa nënshkruar	
Faktet tona janë:	

1. Shkresat mes AKK dhe OE të cilat i ka nënshkruar projekt menaxheri Omur Engin Demirkol.
2. Certifikata e biznesit – Drejtor Abdullah Yusuf Ekinci.

3. Lista e stafit te EMI-t nga kontabilisti ku nuk figuron si staf Fisnik Loshi.

Eksperti shqyrtues e cek se Fisnik Loshi ka qenë i punësuar në kompani në 2010, kërkojmë nga ju të ofroni fakte, ndërsa ne mund të ju dëshmojmë të kundërtën me listën e stafit të vulosur nga kompania që i ka kryer këto punë dhe ka evidence për këto. Gjithashtu shtrohet pyetja diploma master të cilin e posedon Fisnik Loshi pse nuk e ka titullin Master në fushën e Gjeodezise dhe Kadastrit.
Gjitha pretendimet e ekspertit janë të pa bazuara dhe nuk posedon fakte, prandaj ne kërkojmë rivlerësim të lëndës dhe kërkojmë që të mos na mohohen të drejtat tona.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE Geomap z.Vertopi deklaroj: Të nderuar të pranishëm, OE Geomap&Sfera pajtohet me konstatimet e ekspertit shqyrtues duke konsideruar raportin ligjor, objektiv dhe profesional. Vendimi i AK-së për çështjen e referencës për z.Fisnik Loshi është i pabazuar për arsye se në dosje të tenderit nuk është kërkuar që referenca të jetë e nënshkruar por vetëm e lëshuar nga punëdhënësi, andaj referenca e z.Loshi është valide ngase është lëshuar nga vet punëdhënësi. Ne e njoftojmë panelin se drejtori menaxhues i OE Urban Metropol është z.Erhan Jusuf që është prezent këtu, që i njëjti ka qenë drejtor i firmës turke Emi Harita.
Kjo është arsyeja kryesore pse kompania turke Emi Harita tani kundërshton përmbajtjen e referencës për z.Loshi, ngase jemi konkurrent të drejtpërdrejt në këtë procedurë konkurrimi dhe padrejtësisht AKK mbështetet në këtë mohim të referencës nga Emi Harita me seli në Stamboll.
Ne kundërshtojmë çdo pohim të pabazë të AK-së për përvojën, titullin akademik dhe licencën e z.Loshi ngase ka më shumë se tri vite përvojë pune specifike. Për të argumentuar punën, titullin Master për menaxhimin e tokave në Suedi dhe përvojën e z.Loshi në ankesë kemi bashkangjitur kopjet e kontratave, licencën, kopjen e titullit shkencor, procesverbalet e punës dhe transaksionet bankare që dëshmojnë përvojën e tij profesionale.

Kryetari i panelit shqyrtues në vazhdim të seancës kërkoj nga përfaqësuesi i OE Geomap të prezantoj kontratën dhe vendimin për caktimin e z.Loshi për të cilin është lëshuar referenca nga Orhan Jusuf për projektin rikonstruimi i të dhënave kadastrale për Prizren dhe Vlashnje.

Në përgjigje z.Vertopi deklaroj: Edhe pse kërkesa e z.Dina për përvojën dhe kontratën e z.Loshi janë cek dhe argumentuar në ankesë, prapa ritheksojmë se z.Loshi ka qenë i angazhuar në projektet e rindërtimit të informacioneve kadastrale si në vijim : Projekti i parë rindërtimi i informacioneve kadastrale në 26 zona kadastrale, Ndërmarrja Bllum Info periudha anagzhimit 27.11.2006 deri me 01.03.2008. Projekti dytë Rindërtimi i infmroacioneve kadastrale në Prizren, ndërmarrja Emi Harita periudha angazhimit 15.08.2010

deri me 15.120.2010. Dëshmi për këtë ja ofroj panelit kontratën-nënkontraktimin Urban Metropol shpk dhe Nëse shpk me Agjencinë Kadastrale të Kosovës e datës 02.08.2012 – Rikonstruimi i informacioneve kadastrale në Prizren. Po ashtu keni referencën nga Bllum Info, dhe do të ju ofrojmë prapë gjitha dokumente e kërkuara brenda ditës së sotme.

Paneli shqyrtues konstatoi se përfaqësuesi i OE Geomap nuk arriti të nënshkruaj kontratë të punës apo vendim të caktimit të menaxherit lidhur me referencën e datës 15.12.2010 të z.Fisnik Loshi.

Në vazhdim të seancës z.Vertopi deklaroj: Sot pasdite do të ju dërgojmë komplet dokumentin që kërkon kryesuesi i panelit shqyrtues, për të gjitha projektet që janë të listuara duke përfshirë edhe projektin për rindërtimin e informacioneve kadastrale në Prizren dhe Vlashnje të vitit 2010.
Ne ritheksojmë se shkresa zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, është shkresë zyrtare dhe ligjore që konfirmon se anëtari i jonë i konsorciumit Ave Consulting ka pas me agjencinë e Legalimit Urbanizmit dhe integrimit të zonave informate e datës 07.03.2018 i realizuar në Durrës, është ngjashmëri të plotë me termat e referencës për Projektin e rindërtimit të informacioneve kadastrale në Kosovë dhe OE kundërshton fuqishëm çdo tentim të Lroenco që në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ të AKK të zyrtarizoj gjeodetët nga Shqipërisë dhe Turqia për punë profesionale dhe specifike në Kosovë për projektin në fjalë pa pas licencim paraprak nga AKK. Duke ofruar CV të tyre në gjuhë Turke dhe duke pas gabime administrative në formularin e tenderit që është në kundërshtim me LPP.
I propozojmë panelit shqyrtues që konsorciumi Geomap&Ave Consulting&Sphera&neës" kërkon nga paneli që pas shoshitjes së fakteve të përkrahet raporti i ekspertit që lënda të kthehet në Rivlerësim dhe oferta e OE tonë të shpallet fitues dhe të detyroj AK-në të respektoj dhe zbatoj dy vendime të drejta dhe ligjore të OSHP-së datës 10.05.2018 dhe urdhëresën er datës 03.08.2018, ngase në këto dy vendime ligjore dhe të drejta është konstatuar ligjërisht dhe në mënyrë profesionale se Lorenco & Urban metropol janë totalisht të papërgjegjshme.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z.Shyqeriu deklaroj: ne si AK bazuar në vlerësimin e fundit të datës 15.08.2018, kemi hasur gjatë rivlerësimit në referencën e datës 15.12.2010 e cila është e panënshkruar dhe për të njëjtën ka kërkuar nga kompania e cila pretendohet se e ka lëshuar që përmes e-mailit ta konfirmoj nëse e njëjta është e vërtetë dhe lëshuar nga ajo komani. Lidhur me këtë kërkesë AK me 22 Gusht 2018 ka pranuar përgjigjen se e njëjta nuk është lëshuar nga ajo kompani. Por si do që të jetë për sqarime tjera për këtë çështje AK sot me 19.09.2018 ka deponuar një kërkesë në OSHP me cilën ka kërkuar që grupi Geomap etj në pajtim me dispozitat e nenit 65 dhe 99 të LPP-së të bëjë diskualifikimin e saj në

prokurim publik, pasi që bazuar në arkivin e AKK gjendet kontrata me EMI HARITA ku nuk gjendet z.Loshi si projekt menaxher për referencën diskutabile e cila bazuar në gjitha këto fakte që përmendem më lart konstatohet të jetë jo e vërtetë. Sa i përket mendimit të ekspertit ne e kundërshtojmë në tërësi dhe deklarohemi edhe për grupin e OE-ve Lorenco&co etj, për arsyen që është shpall i papërgjegjshëm që ka të bëjë me vlerësimin e krahasimit mes të Gjeodetit dhe Topografit mund të deklarohet kolegu im nga AKK.

Gjatë prezantimit në seancë z. Reshat Murati deklaroj: sa i përket ngjashmërisë mes profesionit Topograf, gjeodet, ekspert i gjeoinfarmcionit, AKK ka pranuar tituj të tillë si Gjeodet dhe ka shpreh mendimin e tij në vlerësimin e tretë të komisionit vlerësues. Mirëpo prapë AKK ka pranuar dhe ka pazbatuar në plotësi vendimin dhe urdhëresën e OSHP-së 218/18, dhe sipas vendimit dhe urdhëresës e ka kualifikuar të papërgjegjshëm Liorenco&CO&urban Metropol.
Edhe pse kemi vlerësuar se vendimi është jo i saktë ne kemi respektuar vendimin e OSHP. AK duke dashtë të zbatoj në plotni urdhëresën e OSHP për ta kaulifikaur të përgjegjshëm OE Geomap ka has në dokumentin e cekur sa here tani, që për referencën e z.Loshi e cila është e panënshkruar. AK e ka shpall të papërgjegjshëm vetëm për këtë dokument, dhe po të sillte kushdo nga Emi Harita dokument që vërteton se atë referencë, ne do kërkonim diskualifikim edhe për OE tjetër pasi do të jetë dokument i pavërtetë, pasi siç e ceka ai projekt ka qenë me AKK. Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe kërkojmë nga panel të vërtetoj vendimin për anulim të këtij aktiviteti me që dy OE-të janë të papërgjegjshëm.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit z.Beqiri deklaroj: Referenca që kontestohet nuk di se ku e bazon AK arsyetimin se është e pa nënshkruar. Nëse vërtet ajo referencë nuk është e saktë sipas deklaratës së AKK. Atëherë le të anuloj AK aktivitetin. Përndryshe qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe rekomandimit të dhënë në raport.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sa i përket referencës së datës 15.12.2010 të ofruar nga OE: N.Sh. "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk – Prishtinë, ku kjo referencë AK-ja pretendon se është e panënshkruar. Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues (AK-ja), duhet të vërtetoj saktë se referenca e kontestuar a është lëshuar nga kompania përkatëse dhe te vërtetohet se e njëjta referencë a e përmbush kërkesën e autorit kontraktues të cekur në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

Lidhur me pretendimin e ankuesit OE "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë, se ka ngjashmëri mes profesionit Topograf dhe gjeodet, paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që me rastin e rivlerësimit ti drejtohet institucioneve kompetente dhe te sqaroj se dëshmitë e ofruara nga ana e OE ankues a janë ne përputhje me kërkesën e autoriteti kontraktues apo jo.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - Agjencia Kadastrale e Kosovës

1x1 OE - "Geo - Map" & "Ave Consulting" shpk & "Sphaera" shpk & "Newa" shpk - Prishtinë

1x1 OE - "Lorenco & Co" shpk & "Urban Metropol" shpk – Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.